




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SKRAPAR

RELACION

PËR

PROGRAMIN BUXHETOR AFATMESËM 2024-2026 TË
BASHKISË SKRAPAR DHE INSTITUCIONEVE NË VARËSI TË SAJ



Lista e Shkurtimeve

PBA	– Programi Buxhetor Afatmesëm
NJVV	– Njësi e Vetëqeverisjes Vendore
EMP	– Ekipi i Menaxhimit të Programit
GMS	– Grupi për Menaxhimin Strategjik
MFE	– Ministria e Financave dhe Ekonomisë
FPT	– Instrumenti i Planifikimit Financiar
INSTAT	– Instituti i Statistikave
PBB	– Produkti i Brendshëm Bruto

BAZA LIGJORE

Ligji Nr. 9936 dt. 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në R.SH”, neni 6,15,17,22,23,24,25,26,32, i ndryshuar me Ligjin Nr.57/2016 “Për disa ndryshime në Ligjin Nr. 9936, dt.26.06.2008”, ligji Nr. 9632 datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, Ligji Nr. 139/2015, dt. 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Ligji Nr.68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, Udhëzimi i Ministrisë Financave Nr.23, datë 30.07.2018, “Për Procedurat Standarte të Përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”, Udhëzimi Nr.7, datë 25.02.2022 “Për një ndryshim në Udhëzimin Nr.23, datë 30.07.2018 “Për Procedurat Standarde të Përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”, Udhëzimi Plotësues i Ministrisë Financave Nr.6/1, datë 28.02.2018, “Për Përgatitjen e Buxhetit Vendor”, Udhëzimi i Ministrisë Financave dhe Ekonomisë Nr.6, datë 28.02.2023 “Për Përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2024-2026”, Ligji Nr. 9920, dt. 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, Ligji Nr. 9975, dt. 28.07.2008 “Për Taksat Kombëtare”, VKM-ja Nr.325, Dt. 31.05.2023 “Për miratimin e strukturës së pagave, nivelit të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të nëpunësve civil dhe nëpunësve në disa Institucione të Administratës Publike”, VKM-ja Nr.326, Dt. 31.05.2023 “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të Administratës Publike”, VKM -ja Nr.328 Dt.31.05.2023 “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionareve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civile e të punonjësve Administrative të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”, VKM-ja Nr.113, Dt. 01.03.2023 “Për Përcaktimin e Pagës Minimale në shkallë Vendi”, VKM -ja Nr. 240, Dt.20.04.2023 “Për një ndryshim në vendimin Nr.350, Dt. 19.04.2017, të Këshillit të Ministrave , “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi”, të ndryshuar, VKM-ja Nr.241, Dt.20.04.2023 “Për disa ndryshime në vendimin Nr.175, Dt.08.03.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve mësimor dhe të punonjësve të tjerë jomësimor në Arsimin Parauniversitar”, të ndryshuar, VKM-ja Nr.242, Dt.20.04.2023 “Për disa ndryshime në VKM Nr.234, Dt.20.04.2022, të Këshillit të Ministrave, “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa Institucione të Administratës Publike”, të ndryshuar

1. HYRJE

1.1. Roli dhe qëllimi i Programit Buxhetor Afatmesëm, si një instrument efektiv planifikimi në nivel vendor.

Programi Buxhetor Afatmesëm (PBA) është një instrument për prezantimin në mënyrë të integruar e disa vjeçare të parashikimit të të ardhurave dhe burimeve financiare publike për planifikimin, menaxhimin dhe lëvrimin e shërbimeve publike. Si i tillë, ai është një komponent kryesor i planifikimit kombëtar dhe vendor.

Strategjia Kombëtare e Zhvillimit, Strategjitë Sektoriale dhe Planet e Përgjithshme Vendore shpjegojnë atë që qeveria synon të arrijë në fushat kryesore të ofrimit të shërbimeve, cilat struktura të qeverisë do të përfshihen dhe si do të ndërveprojnë me organizatat e sektorit privat dhe aktorë të tjerë joqeveritarë. Si të tilla, ato përshkruajnë mënyrën sesi qeveria synon të zhvillojë komponentët kryesorë të ofrimit të shërbimeve, investimet kryesore publike që do të kërkojnë dhe implikimet përkatëse për nivelin dhe llojin e shërbimeve publike që do të ofrohen. Aspekti strategjik i këtyre dokumenteve i jep formë kërkesave për shpenzime, për investime publike si dhe për ofrimin e shërbimeve gjatë periudhave disavjeçare.

Ashtu si edhe nivelet e tjera të qeverisjes, Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore (NJVQV-të) janë përgjegjëse për menaxhimin e fondeve publike. Kjo përfshin mbledhjen e taksave, tarifave vendore dhe menaxhimin e burimeve kombëtare që transferohen në bashki nga qeveria qendrore, disa prej të cilave kushtëzohen për shërbime specifike. Kjo do të thotë se kërkohet një instrument për të projektuar burimet e përgjithshme që disponohen, për shpenzimet vendore, duke përfshirë këtu: grantet, huatë, taksa e tarifat vendore dhe transferime nga qeveria qendrore (të kushtëzuara dhe të pakushtëzuara).

Njësitë e vetëqeverisjes vendore ofrojnë shërbime publike vendore bazuar në kompetencat që u jep ligji. Si rrjedhojë, kjo kërkon një instrument për të lehtësuar dhe menaxhuar mënyrën e përdorimit të burimeve gjithsej, duke përfshirë vendimet për llojin e shpenzimeve (pagat dhe sigurimet; mallrat dhe shërbimet, interesat e borxhit, ri pagimi i huave dhe kështu me radhë), si dhe vendimet strategjike se si do të alokohen burime midis llojeve të ndryshme të shërbimeve publike (sigurisë publike, arsimit, shëndetësisë, punëve publike dhe kështu me radhë).

Procesi i PBA-së, prezanton në mënyrë të integruar informacionin mbi parashikimet e të ardhurave dhe burimeve gjithsej dhe përcakton objektivat përse do të shpenzohen ato, kostot e nevojshme dhe llojin e secilit shërbim që do të ofrohet. Ndër të tjera, kjo përfshin lidhjen e qëllimeve dhe objektivave të bashkisë me qëllime strategjike të përcaktuara në strategjitë lokale dhe kombëtare. Procesi i PBA-së, disiplinon maturinë financiare vendore duke planifikuar shpenzimet publike brenda një kuadri realist financiar vendor. Në të njëjtën kohë, ai synon të garantojë që shërbimet publike vendore plotësojnë nevojat në rritje të banorëve duke treguar se shpenzimet publike për prioritetet strategjike të zhvillimit të njësisë vendore përkthehen në vendime konkrete për ofrimin e shërbimeve publike vendore, me lidhje të qarta mes politikave vendore dhe prioriteteve vjetore të shpenzimeve .

Në procesin e PBA-së planifikimi dhe buxheti vendor afatgjatë e ndihmon njësinë vendore të planifikojë sesi shërbimet publike do të evoluojnë me kalimin e kohës, duke përcaktuar kërkesat disavjeçare të shpenzimeve në fusha të ndryshme të ofrimit të shërbimeve në përputhje jo vetëm me ndryshimet e parashikuara në demografinë, por edhe në përputhje me ndryshimin e nevojave të banorëve të bashkisë. Kombinimi i këtij informacioni me parashikimin për nevojat dhe burimet në dispozicion në të ardhmen, u mundëson njësisë vendore që të planifikojnë shërbime publike në mënyrë të qëndrueshme, si dhe të zhvillojnë një kuadër afatmesëm të burimeve si bazë për planifikimin afatmesëm të shpenzimeve.

Gjithashtu, procesi i PBA-së siguron një kornizë për planifikimin e investimeve publike sipas programeve buxhetore duke përfshirë edhe kërkesat për shpenzimeve koherente. Kjo siguron një bazë të fortë mbi të cilën mund të merren vendimet për investime, të lidhura me planet strategjike dhe planet afatmesme për zhvillimin e shërbimeve të ndryshme publike që njësia vendore ofron për banorët.

Në mënyrë të përmbledhur Programi Buxhetor Afatmesëm përfshin këto procese:

- prezanton informacionin mbi të ardhurat dhe burimet e disponueshme të bashkisë;
- përkthen vizionin strategjik të NJVQV-së në plane praktike për ofrimin e shërbimeve gjatë një periudhë disavjeçare;
- shpërndan burimet sipas fushave të veçanta të ofrimit të shërbimeve publike,
- përcakton treguesit e performancës në secilën fushë të ofrimit të shërbimeve;
- llogarit kërkesat vjetore të shpenzimeve (koherente dhe për investime) në përputhje me objektivat dhe treguesit e performancës për një periudhë disavjeçare;
- përcakton treguesit vjetorë të performancës në përputhje me parashikimet për burimet në dispozicion përgjatë një periudhe disavjeçare.

Në qendër të PBA-së janë dy procese planifikimi dhe buxhetimi që NJVQV-të ndërmarrin për të planifikuar treguesit e performancës dhe shpenzimet afatmesme, si dhe propozimet për buxhetet vjetore:

1. Përcaktimi i Qëllimeve dhe Objektivave të Programit (nëpërmjet Rishikimit të Politikës së Programit);
2. Planifikimi i Shpenzimeve të Programit (në funksion të ofrimit të shërbimeve).

Procesi i *Rishikimit të Politikës së Programit*, synon të specifikojë qëllimet, objektivat e programit, standardet (ndërkombëtare ose shqiptare), si dhe treguesit e performancës të lidhura me ato në terma SMART¹. Ky informacion konsiston në rezultatet e dëshiruara dhe të matshme nga veprimet e NJVQV-së, të cilat duhet të arrihen në periudhën afatgjatë² (Qëllimet e Politikës së Programit), si edhe arrijtjet e dëshiruara në periudhën tre-vjeçare³, sasinë e produkteve (shërbimeve publike) dhe kostot respektive për arrijtjen e Objektivave të Programit (që janë hapa të ndërmjetëm për arrijtjen e një Qëllimi të Politikës së Programit). Të gjitha shpenzimet e NJVQV-së duhet të kontribuojnë në mënyrë direkte dhe integrale në arrijtjen e Objektivave të Programeve të saj.

Procesi i *Planifikimit të Shpenzimeve të Programit*, synon të përcaktojë sasinë dhe koston e të gjitha shërbimeve publike që NJVQV-ja planifikon të ofrojë gjatë çdo viti të periudhës afatmesme, të shprehura në formën e produkteve SMART të programit. NJVQV-ja, specifikon produkte që sigurojnë arrijtjen e të gjitha Objektivave të Programit, Qëllimeve të Politikës së Programit si dhe standarteve e treguesve të performancës të lidhura me ato.

Si të tilla, proceset e Rishikimit të Politikës së Programit dhe Planifikimi i Shpenzimeve të Programit përfaqësojnë zemrën e procesit të PBA-së, dhe informacioni i gjeneruar nga këto procese paraqitet në mënyrë të detajuar në Seksionin 3, të dokumentit të PBA-së.

¹ Specifike, Matshme, Arritshme, Rëndësishme, Terma Kohore.

² ‘Afatgjatë’ I referohet një kohe të specifikuar nga Drejtuesi i Programit, që shkon përtej periudhës 3-vjeçare të programit buxhetor afatmesëm.

³ Për tu specifikuar për secilin vit të periudhës 3-vjeçare të programit buxhetor afatmesëm.

Këto qëllime, objektiva, standarde dhe produkte përbëjnë kornizën e performancës për shërbimet publike të NJVQV.

Një element i rëndësishëm i procesit të përgatitjes së PBA-së është specifikimi i Treguesve të Performancës (SMART) për secilën fushë të funksioneve të bashkisë. Kjo përfshin planifikimin dhe kostimin e detajuar të treguesve të performancës brenda secilit funksion të qeverisjes vendore, si dhe prezantimin e këtyre treguesve për miratim tek vendimmarrësit dhe më pas për publikun e gjerë në formën e:

- Produkteve SMART, që specifikojnë në detaje shërbimet publike të planifikuara për t'u ofruar;
- Objektiveve SMART të Politikës së Programit (dhe treguesve të performancës të lidhura me ato), që specifikojnë arritjet kryesore vjetore nga ofrimi i shërbimeve publike;
- Qëllimeve SMART të Politikës së Programit (dhe treguesve të performancës të lidhura me ato), që bashkia planifikon të arrijë në periudhën afatgjatë;
- Kostot totale të ofrimit të shërbimeve vendore, duke treguar se si njësia vendore planifikon të përdorë burimet në dispozicion;
- Kostot e planifikuara për produktet (shërbimet) individuale, në mënyrë që vendimmarrësit dhe banorët të kuptojnë efikasitetin e planifikuar në ofrimin e shërbimeve të veçanta.

1.2 Fazat e përgatitjes dhe miratimit të PBA-së.

Udhëzimi Standart⁴ i PBA-së, përcakton kërkesat kryesore të procesit të PBA-së për NJVQV, si dhe kërkesat përkatëse për raportim brenda bashkisë apo tek qeveria qendrore. Aspektet kryesore të udhëzimit standart përfshijnë:

- Rolet dhe përgjegjësitë në procesin e përgatitjes së PBA-së për Kryetarin e NJVV-së, Këshillin e NJVQV, GMS, Zyrtarët Autorizues dhe Ekzekutues, Drejtuesit dhe anëtarët e EMP-ve, si dhe MFE-së;
- Procedurat, fazat e ndryshme, kalendarin dhe metodologjinë për programimin dhe buxhetimin e bazuar në performancë në përgatitjen e PBA-së;
- Kërkesat e raportimit të programit buxhetor afatmesëm. Më konkretisht, kërkesat për të përgatitur dhe prezantuar: Misionin e njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe strukturën e programeve; Deklaratat e politikës së programeve; Tavanet e njësisë së vetëqeverisjes vendore sipas programeve; Shpenzimet e programeve sipas artikujve; Shpenzimet e programeve sipas produkteve; Projektet me financim të brendshëm; Projektet me financim të huaj; Formatet plotësuese të kërkesave buxhetore; Projekt planin e arkës, i cili dorëzohet në përfundim të fazës së dytë të përgatitjes së kërkesave buxhetore; Raportet e kërkesave shtesë (Kërkesat shtesë sipas produkteve; Kërkesat shtesë sipas artikujve buxhetor)

Udhëzimi Vjetor i PBA-së, përcakton kërkesat specifike për procesin e PBA-së në NJVQV duke përfshirë edhe kërkesa të veçanta për prezantimin e informacionit në këtë dokument. Aspektet kryesore të udhëzimit vjetor për Përgatitjen e PBA-së 2024-2026 përfshijnë:

- Afatet specifike për përgatitjen e dokumentit të PBA-së dhe Informacionin mbi transfertën e pakushtëzuar të përgjithshme dhe atë sektoriale për NJVQV-të;

⁴ Udhëzimi Nr. 23, datë 30.07.2018 i Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë për "Procedurat Standarte të Përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm të Njësisë të Vetëqeverisjes Vendore", i ndryshuar.

- Procesin e përgatitjes së PBA, p.sh. proceset për përgatitjen e vlerësimit dhe parashikimit të të ardhurave; Tavanëve të përgatitjes së PBA-së; Organizimit të procesit; Pemës së programeve; Draft dokumentit të PBA-së;
- Instrumentin e Planifikimit Financiar (FPT).

Faza 1 e procesit të PBA-së, zhvillohet midis Janarit dhe Qershorit. Kjo është faza strategjike kur merren të gjitha vendimet kryesore për financimin e politikave dhe investimeve të reja. Kjo fazë përmbyllet me përgatitjen e projekt dokumentit të PBA-së, i cili përdoret nga NJVV-ja për të realizuar alokimin strategjik burimeve midis programeve me qëllim përgatitjen e planeve afatmesme të shpenzimeve dhe buxhetit vjetor gjatë fazës teknike të përgatitjes së këtij dokumenti. Në fund të kësaj faze, dokumenti i PBA-së bëhet publik në faqen e internetit të NJVQV-ve për qëllime konsultimi, si dhe dërgohet në MFE, brenda datës 1 qershor e cila përgatit komente dhe rekomandime.

Faza 2 e procesit të PBA-së, zhvillohet midis Korrikut dhe Shtatorit. Kjo është faza teknike gjatë së cilës ekipet e menaxhimit të programeve të njësisë vendore marrin vendimet përfundimtare mbi planet për ofrimin e shërbimeve publike gjatë tre viteve të ardhshme. Gjatë kësaj faze përfshihen vendimet mbi përmbajtjen e projekt buxhetit vjetor që do t'i paraqiten GMS të NJVQV-së. Në përfundim të kësaj faze, përgatitet një version i rishikuar i dokumentit të PBA-së, i cili përdoret nga NJVQV për të vendosur mbi detajet në lidhje me shërbimet publike që do ofrohen si dhe alokimin e shpenzimeve që do të bëhen pjesë e Buxhetit Vjetor. Dokumenti i Rishikuar i PBA-së bëhet publik në faqen e internetit të NJVQV-ve për qëllime konsultimi.

Për periudhën nga tetori deri në muajin dhjetor NJVQV-ja, merret me finalizimin e dokumentit të PBA-së, si dhe miratimin e Buxhetit Vjetor. Gjatë kësaj faze, GMS përgatit një version përfundimtar të PBA-së në përputhje me vendimet e Këshillit të NJVQV-së. Projekt buxheti Vjetor është viti i parë i Projekt Buxhetit Afatmesëm dhe i paraqitet Këshillit të NJVQV-në për miratim (jo më vonë se data 30 nëntor) në një format standard (siç përcaktohet në Udhëzimin Plotësues të PBA-së). Një version përfundimtar i dokumentit të PBA-së (përfshirë Buxhetin Vjetor) publikohet dhe i vihet në dispozicion publikut të gjerë përmes faqes së internetit të NJVQV-së.

2. Vështrim i Përgjithshëm i Bashkisë

2.1 Situata e Njësisë së Vetëqeverisjes Vendore

Bashkia Skrapar shtrihet brenda territorit të Qarkut Berat. Rajoni gjendet në pjesën qendrore dhe atë jugore të trungut të brendshëm të vendit dhe ka si kryeqendër qytetin e Çorovodës. Në nivel qarku Bashkia Skrapar shtrihet në pjesën juglindore dhe kufizohet në veri me Bashkinë e Gramshit të qarkut të Elbasanit ndërsa në lindje me bashkinë Maliq dhe Korçë të qarkut të Korçës. Në jug kufizohet me bashkinë Këlcyrë dhe Përmet të qarkut të Gjirokastrës, dhe në perëndim me bashkinë Poliçan të të njëjtit qark. Kryeqendra e Bashkisë Skrapar është qyteti Çorovodës. Në bazë të Ligjit nr. 115/2014 “Për Ndarjen Administrative-Territoriale të Njësisve të Qeverisjes Vendore në Republikën e Shqipërisë”, Bashkia Skrapar u krijua nga bashkimi i nëntë njësisve të qeverisjes vendore: tetë komuna dhe një bashki. Tetë ish komunat sot njësi administrative përbëhen nga 103 fshatra. Territori bashkisë shtrihet në një zonë gjysmë malore dhe malore, mjedisi natyror është i pastër, me shumëllojshmëri peizazhesh dhe burime të pasura natyrore dhe ujore. Elementët natyror të njohur janë, Kanionet e Osunit dhe Parku Kombëtar i Tomorit si destinacione të rëndësishme turistike që ndikojnë në rritjen e ekonomisë lokale.

Një rëndësi të veçantë përbën dhe mjedisi kulturor me monumente të shumta me vlera kombëtare dhe rajonale. Përsa i përket infrastrukturës së transportit, Bashkia mban lidhje rrugore me qytetin kryesor rajonal, Beratin, i cili është qendra urbane më e afërt dhe më e madhe. Infrastruktura rrugore që lidh qytetin e Çorovodës me qendrat e njësive administrative, në distancë të largët si dhe fshatrat e këtyre njësive, është problematike. Kjo si rezultat edhe i sipërfaqes së madhe të territorit të bashkisë Skrapar, rreth 775 km².

Numri popullsisë i regjistruar sipas Censurit të vitit 2011, në këtë bashki rezulton 12.403, banorë. Ndërsa numri popullsisë i regjistruar në Gjendjen Civile është 16,093, banorë. Numri i banorëve është ulur në masë të konsiderueshme nga braktisja e zonave rurale për shkak të mungesës së infrastrukturës rrugore, shërbimit shëndetësor, pamundësisë së arsimimit sidomos atij të mesëm, por dhe të mungesës së punonjësve të kualifikuar në këtë sektor. Pavarësisht mungesës së infrastrukturës rrugore, pozita gjeografike, pasuria natyrore dhe ujore, historia, kultura dhe tradita, përbejnë një potencial për zhvillimin ekonomik të kësaj zone.

2.2 Çështje kryesore për projektet dhe politikat e Bashkisë / Këshillit të Qarkut

Projektet dhe politikat afatmesme dhe afatgjata të bashkisë konsistojnë në ndërhyrjen për përmirësimin e akseve rrugore që lidhin qytetin qendër bashkie me qendrat e njësive administrative si dhe përmirësimi i rrjetit rrugor midis njësive administrative dhe fshatrave. Kjo gjë, përbën sfidë për Bashkinë Skrapar, pasi ka në administrim tetë njësi administrative, të shpërndara në terrene shume të thyera malore, një popullsi në rënie dhe me densitet të ulët në raport me sipërfaqen.

3.-Orientimi afatgjatë i Bashkisë Skrapar

3.1 Strategjia e zhvillimit afatgjatë

Për tu realizuar vizioni për Bashkinë Skrapar janë parashikuar katër objektiva strategjike të cilat do të drejtojnë zhvillimin në të gjithë sipërfaqen territoriale të bashkisë gjatë viteve në vazhdim.

1. **Objektivi Strategjik: 1** Rigjenerimi Ekonomik i Zonës.
2. Zhvillimi balancuar i mëtejshëm ekonomik i zonës mund të arrihet përmes zhvillimit të qëndrueshëm të sektorit bujqësor-blegtoral dhe njëkohësisht përmes fuqizimit të sektorit të përpunimit të produkteve bujqësore dhe blegtorale si dhe promovimit të formave alternative të turizmit. Ky zhvillim ekonomik pritet të kontribuojë dhe në rigjenerimin e popullsisë përkatëse si dhe frenimin e flukseve migratore e cila do të ndikoj në rritjen e popullsisë.
3. **Objektivi Strategjik: 2** Menaxhimi qëndrueshëm i mjedisit.
Ky objektivi strategjik i referohet mbrojtjes dhe përdorimit të drejtë të sistemeve të tokës dhe ato ujore, mbrojtjes së habitateve dhe ekosistemeve (Parku Kombëtar në Tomor, promovimit dhe zhvillimit të peizazheve natyrore dhe gjeomonumenteve, Kanionet e Osumit Kanioni i Gradecit etj) në mënyrë që të arrihet ruajtja e mjedisit natyror të pastër, i cili mund të jetë burim i rëndësishëm për pritjen e formave të ndryshme alternative të turizmit.
4. **Objektivi Strategjik: 3** Zhvillimi Infrastrukturës Teknike.

Është i nevojshëm ndërtimi dhe përfundimi i infrastrukturës teknike për të përmirësuar aksesin e njerëzve dhe mallrave në qendrën e Bashkisë, por edhe në qendra më të vogla administrative në territorin e Bashkisë si dhe në resurset turistike qendrat urbane rajonale dhe infrastrukturave strehim, argëtim, pritjes, që do të çojnë në rimëkëmbjen e zonës. Në nivel bashkiak është problematike lëvizja dhe transporti i njerëzve dhe mallrave nga zonat më të largëta në ato qendrore.

5. **Objektivi Strategjik: 4** Zhvillimi komuniteteve të qëndrueshme.

Duke formuar komunitete të qëndrueshme synohet përmirësimi i cilësisë së jetës të banorëve dhe promovimi i identitetit të fortë të bashkisë në lidhje me produktet bujqësore dhe blegtorale cilësore, të certifikuara si dhe burimeve natyrore.

3.2. Sfidat kryesore të zhvillimit/ paraqitja e projekteve kryesore – arsyet dhe përfituesit

- Shpopullimi i zonave me potencial në zhvillimin e bujqësisë dhe blegtorisë.
- Mungesa e infrastrukturës rrugore e cila pamundëson lëvizjen e njerëzve dhe mallrave në zonat urbane.
- Mungesa e shërbimit shëndetësor për arsye të mungesës së personelit që ofrojnë këtë shërbim dhe qendrave shëndetësore dhe ambulancave.
- Mungesa e personelit të kualifikuar në sektorin e arsimit dhe ambienteve ku zhvillohet procesi mësimor
- Edhe pse ka bollëk të burimeve ujore problem mbetet furnizimi me ujë i popullsisë në të gjitha zonat e banuara.
- Edhe pse nuk mungojnë produktet cilësore si ato bujqësore dhe blegtorale problem mbetet shitja e tyre pasi nevojat e popullsisë së qytetit të Çorovodës janë të vogla në raport me sasinë e ofruar të tyre.

4.-BUXHETI AFATMESËM I BASHKISË SKRAPAR 2024-2026

Ky seksion i kushtohet alokimit të burimeve për shpenzime publike të Bashkisë Skrapar gjatë periudhës 2024-2026, si dhe projekteve kryesore të investimeve publike.

Nën seksioni i parë, prezanton të ardhurat e parashikuara për periudhën 2024-2026, me një shpjegim për secilin grup të të ardhurave së bashku me supozimet kryesore të bëra gjatë parashikimit.

Nën seksioni i dytë, paraqet një përmbledhje të planeve të shpenzimeve të Bashkisë, për vitet 2024-2026. Ky nën seksion prezanton informacionin mbi shpenzimet totale sipas kategorive ekonomike, programit dhe funksioneve qeverisëse.

Tabela 1 paraqet të dhëna bazë mbi bashkinë që përshkruajnë demografinë, sipërfaqen, komunitetin dhe bazën e biznesit, kapacitetin menaxhues, etj

Tabela 1. Të dhëna bazë mbi Bashkinë Skrapar

Të Dhëna Bazë mbi Bashkinë SKRAPAR						
	Të Pergjithshme	2019	2020	2021	2022	2023
Numri i Njësive Administrative	8					
Numri i Fshatrave	92					
Sipërfaqja e Bashkisë (km2)	833					
Qyteti	53					
Njësitë Administrative	780					
Sipërfaqja e Bashkisë (km2)	833					
Zonë Urbane	8					
Tokë Bujqësore	115					
Kullota	198					
Pyje	302					
Popullsia e Bashkisë		16,435	16,246	16,158	16,113	16,093
Qyteti		5,443	5,640	5,523	5,426	5,397
Njësitë Administrative		10,992	10,606	10,635	10,687	10,696
Mosha Mesatare e Popullsisë		0	0	0	0	0
Numri i Lindjeve		109	35	38	40	10
Numri i Vdekjeve		119	111	113	115	120
Numri i Bizneseve Aktive		187	183	175	170	173
Numri i Familjeve		6,027	6,084	6,042	6,080	6,078
Qyteti		2,100	2,115	2,113	2,110	2,120
Njësitë Administrative		3,927	3,969	3,929	3,970	3,958
Numri i Punonjësve të Bashkisë me Kohë të Plotë		378	340	362	362	370
Administrata e Bashkisë		90	82	90	90	90
Njësitë Shpenzuese		288	258	272	272	272
Numri i Punonjësve të Bashkisë me Kohë të Pjesëshme		8	8	8	8	8
Administrata e Bashkisë		0	0	0	0	0
Njësitë Shpenzuese		8	8	8	8	8
Numri i Programeve Buxhetore		14	15	15	20	15


4.1 Të Ardhurat dhe Shpenzimet Publike të Bashkisë Skrapar në vitet 2024-2026

4.1.1 Të ardhurat e parashikuara të Bashkisë Skrapar për vitet 2024-2026

Ky nën seksion paraqet një përshkrim të secilit prej burimeve kryesore të të ardhurave, duke përfshirë të ardhurat e veta, taksat e ndara, transfertën e përgjithshme të pakushtëzuar dhe transfertat e pakushtëzuara sektoriale, transfertën e kushtëzuar, huamarrjet dhe të ardhurat e trashëguara. Informacioni jepet mbi: të ardhurat faktike të dy viteve të fundit; buxhetin fillestar dhe të pritshmërinë për vitin koherent; dhe parashikimet për tre vitet e ardhshme.

Tabela 2. Të ardhurat e Bashkisë sipas burimeve kryesore

EMERTIMI BURIMEVE BUXHETORE	Fakti	Fakti	I Pritshmi	PLANI	Parashikim	Parashikim
	2021	2022	2023	2024	2025	2026
TE ARDHURAT NGA TAKSAT DHE TARIFAT VENDORE	53,896,600	87,102,820	70,000,000	70,000,000	70,000,000	70,000,000
TRANSFERTA E PAKUSHTEZUAR E PERGJITHSHME	129,814,259	137,428,284	146,454,805	176,278,000	167,092,000	178,641,000
TRANSFERTA E PAKUSHTEZUAR SEKTORIALE	109,528,285	134,477,107	130,904,173	140,806,000	140,806,000	140,806,000
FONDE TE TRASHEGUARA NGA VITI MEPARSHEM	10,192,759	12,947,784	37,724,678			
TOTALI PLANIT	303,431,903	371,955,995	385,083,656	387,084,000	377,898,000	389,447,000




Nga paraqitja grafike të të ardhurave sipas burimeve buxhetore vërejmë se transfertat nga buxheti qendror (Transferta e Pakushtëzuar e Përgjithshme dhe Transferta e Pakushtëzuar Sektoriale), zënë pjesën më të konsiderueshme të totalit të fondeve buxhetore. Të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore janë parashikuar në të njëjtin nivel për periudhën e PBA 2024-2026.

Ndërsa transfertat nga buxheti qendror kanë një rritje të dukshme duke i krahasuar me vlerën e viteve paraardhëse.

TABELA E FONDEVE BUXHETORE FAKT 2021-2022/ I PRITSHMI 2023 PLANI 2024 DHE PARASHIKIMI 2024-2026

EMERTIMI BURIMEVE BUXHETORE	Fakti	Fakti	I Pritshmi	PLANI	Parashikim	Parashikim
	2021	2022	2023	2024	2025	2026
TOTALI FONDEVE BUXHETORE	303,431,903	371,955,995	385,083,656	387,084,000	377,898,000	389,447,000

TOTALI FONDEVE BUXHETORE FAKT 2021-2022 , PLAN 2023 DHE PARASHIKIMI 2024-2026




Nga paraqitja grafike e totalit të burimeve buxhetore vërejmë një rritje graduale nder vite me një diferencë në vitin 2023, kjo për arsye të mbështetjes me transferte të pakushtëzuar të përgjithshme dhe sektoriale me Akt Normativ me destinacion shlyerjen e detyrime të prapambetura nder vite. Ndërsa për periudhën e PBA 2024-2026 shohim një rritje nga viti në vit, kjo vjen si rezultat i parashikimit në rritje të Transfertes të Pakushtëzuar të Përgjithshme e cila parashikohet në raport me parashikimin e rritjes së PPB për këtë periudhë.

Ky nën seksion paraqet informacion mbi të ardhurat e veta, përfshirë ato faktike për dy vitet e mëparshme, të pritshme për vitin aktual dhe parashikimet për periudhën tre-vjeçare të PBA-së. Informacioni mbi supozimet që qëndrojnë në themel të këtyre parashikimeve paraqitet për secilin zë kryesor të të ardhurave të veta.

BURIMET E VETA BUXHETORE		2021	2022	2023	2023	2024	2025	2026
		Fakti	Fakti	Buxh. Fillestar	Pritshmi	Plani	Plani	Plani
A	TE ARDHURAT NGA BURIMET E VETA	53,896	87,032	70,000	70,000	70,000	70,000	70,000
A.1	Të Ardhura nga Taksat Lokale	9,356	9,095	14,030	14,030	14,030	14,030	14,030
A.2	Të Ardhurat nga Taksat e Ndara	9,329	8,733	9,400	9,400	9,400	9,400	9,400
	TOTAL TE ARDHURA NGA TAKSAT	18,685	17,828	23,430	23,430	23,430	23,430	23,430
A.3	Të Ardhurat nga Tarifatat Vendore	25,978	27,213	36,087	36,087	36,087	36,087	36,087
A.4	Të Ardhurat e Tjera	9,233	41,992	10,482	10,482	10,482	10,482	10,482
	TOTAL TE ARDHURAT NGA TARIFAT	35,211	69,204	46,570	46,570	46,570	46,570	46,570

Paraqitja grafike e të ardhurave nga burimet e veta të ndara të taksa dhe tarifa fakt 2021-2022, plan 2023 dhe parashikimi për periudhën e PBA-së, 2024-2026



Sa vërejmë nga paraqitja grafike janë të ardhurat nga tarifatat ato që zënë peshën më të madhe të të ardhurave nga burimet e veta. Nga tabela gjithashtu shohim se për vitin 2022, totali i të ardhurave në zërin A.3 dhe A.4 është në vlerën prej 69,204 mijë leke, të ndara përkatësisht :

- Të ardhura nga Tarifatat vendore në vlerën prej 27,213 mijë lekë
- Te ardhura të tjera në vlerën prej 41,992 mijë lekë. Në këtë vlerë përfshihet vlera prej 24.190 mijë lekë nga kontrata për dhënie në përdorim të një sipërfaqe të konsiderueshme, prone e Bashkisë.

Nisur nga ky fakt parashikimi për periudhën e PBA-së të të ardhurave nga burimet e veta është në vlerën 70.000.000 leke për çdo vite të kësaj periudhë. Te ardhurat nga taksat vendore dhe taksa e ndarë janë parashikuar në vlerën prej 23,430,000 lekë, ndërsa të ardhurat nga tarifatat vendore dhe të ardhurat e tjera janë parashikuar në vlerën prej 46,570,000 lekë. Në total, të ardhurat nga burimet e veta janë parashikuar në vlerën prej 70,000,000 lekë.

Tabela e paraqitjes analitike të të ardhurave nga burimet e veta dhe nga transfertat nga buxheti qendror.

BURIMET BUXHETORE		2021	2022	2023	2023	2024	2025	2026
		Fakti	Fakti	Buxh. Fillestar	Pritslumi	Plani	Plani	Plani
A	Të Ardhura nga Burimet e Veta	53,896	87,103	70,000	70,000	70,000	70,000	70,000
A.1	Të Ardhura nga Taksat Lokale	9,356	9,094	14,030	14,030	14,030	14,030	14,030
A.1.1	Taksa vendore mbi biznesin e vogël	0	72	0	0	0	0	0
A.1.2	Taksa mbi pasurinë e paluajtshme	7,840	7,895	13,120	13,120	13,120	13,120	13,120
A.1.2.1	Taksa mbi ndërtesën	2,301	2,840	3,583	3,583	3,583	3,583	3,583
A.1.2.2	Taksa mbi tokën bujqësore	4,919	4,720	8,398	8,398	8,398	8,398	8,398
A.1.2.3	Taksa mbi truallin	620	328	1,049	1,049	1,049	1,049	1,049
A.1.2.4	Taksa mbi transaksionet e pasurisë	0	0	0	0	0	0	0
A.1.3	Taksa vendore në shërbimin hotelier	0	7	90	90	90	90	90
A.1.4	Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja	1,330	1,047	750	750	750	750	750
A.1.5	Taksa e tabelës	186	152	160	160	160	160	160
A.1.6	Taksa vendore mbi të ardhurat e krijuara nga dhuratat, trashëgimi, testament dhe llot. Vend.	0	0	0	0	0	0	0
A.1.7	Taksa e përkohëshme	0	0	0	0	0	0	0
A.1.8	Taksa e përkohëshme 1	0	0	0	0	0	0	0
A.1.9	Taksa e përkohëshme 2	0	0	0	0	0	0	0
A.2	Të Ardhurat nga Taksat e Ndara	9,329	8,733	9,400	9,400	9,400	9,400	9,400
A.2.1	Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë / pasuritë e paluajtshme	0	5	0	0	0	0	0
A.2.2	Taksa vjetore për qarkullimin e mjeteve të përdorura	5,985	5,020	5,530	5,530	5,530	5,530	5,530
A.2.3	Taksa e rentës minerare	45	18	20	20	20	20	20
A.2.4	Taksa mbi të ardhurat personale	3,299	3,690	3,850	3,850	3,850	3,850	3,850
A.2.5	Taksa të tjera	0	0	0	0	0	0	0
A.3	Të Ardhurat nga Tarifat Vendore	25,978	27,213	36,087	36,087	36,087	36,087	36,087
A.3.1	Tarifa me menaxhimin të mbetjeve	9,100	12,487	13,177	13,177	13,177	13,177	13,177
A.3.1.1	Tarifa e pastrimit për familjet	3,750	1,310	2,404	2,404	2,404	2,404	2,404
A.3.1.2	Tarifa e pastrimit për institucionet	1,120	1,582	1,574	1,574	1,574	1,574	1,574
A.3.1.3	Tarifa e pastrimit për biznesin	4,230	9,595	9,199	9,199	9,199	9,199	9,199
A.3.2	Tarifa për mbledhjen dhe largimin e mbetjeve	0	0	0	0	0	0	0

A.3.3	Tarifa për ndriçimin publik	1,538	2,051	2,697	2,697	2,697	2,697	2,697
A.3.3.1	Tarifa për ndriçimin publik nga familjet	866	735	1.396	1.396	1.396	1.396	1.396
A.3.3.2	Tarifa për ndriçimin publik nga institucionet	115	225	225	225	225	225	225
A.3.3.3	Tarifa për ndriçimin publik nga biznesi	557	1.090	1.076	1.076	1.076	1.076	1.076
A.3.4	Tarifa për gjelbërimin	345	556	1,789	1,789	1,789	1,789	1,789
A.3.4.1	Tarifa për gjelbërimin nga familjet	195	234	793	793	793	793	793
A.3.4.2	Tarifa për gjelbërimin nga Institucionet	70	75	75	75	75	75	75
A.3.4.3	Tarifa për gjelbërimin nga bizneset	80	247	922	922	922	922	922
A.3.5	Tarifa për shërbimet administrative të bashkisë	5,696	4,109	4,625	4,625	4,625	4,625	4,625
A.3.5.1	Tarifa për shërbimet administrative të bashkisë	107	88	100	100	100	100	100
A.3.5.2	Tarifa për dhënien e licensave, lejeve e autorizimeve	277	30	50	50	50	50	50
A.3.5.3	Tarifa të kontrollit të zhvillimit të territorit	15	208	150	150	150	150	150
A.3.5.4	Tarifa për vulosje veterinarie të bagëtive të therura	0	0	35	35	35	35	35
A.3.5.5	Tarifa e licencimit të veprimtarive të transportit	0	86	100	100	100	100	100
A.3.5.6	Tarifa e parkimit për mjetet e licensuara dhe vendparkime publike	712	737	800	800	800	800	800
A.3.5.7	Tarifa për dhënie license për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj	200	0	0	0	0	0	0
A.3.5.8	Tarifa për pyeje dhe kullotat	3.536	2.508	2.800	2.800	2.800	2.800	2.800
A.3.5.9	Tarifa për shërbimet shtesë nga zjarrëfiksjat	267	22	30	30	30	30	30
A.3.5.10	Tarifa për zënien dhe përdorimin e hapësirës publike dhe fasadave	446	430	450	450	450	450	450
A.3.5.11	Tarifa për trajtimin e mbetjeve inerte në landfille	0	0	0	0	0	0	0
A.3.5.12	Tarifa për linjat ajrore dhe nëntoksore (Telefoni, Energji, TV Kabllor, Internet)	0	0	110	110	110	110	110
A.3.5.13	Tarifa nga dokumentat për tender, ankand etj	137	0	0	0	0	0	0
A.3.6	Tarifa të institucioneve të arsimit, kulturës, sportit etj	1,288	1,097	1,800	1,800	1,800	1,800	1,800
A.3.6.1	Bibloteka	0	0	0	0	0	0	0
A.3.6.2	Muzeumet	0	0	0	0	0	0	0
A.3.6.3	Teatri	0	0	0	0	0	0	0
A.3.6.4	Qendra kulturore e fëmijëve	0	0	0	0	0	0	0
A.3.6.5	Pallati i sportit	0	0	0	0	0	0	0
A.3.6.6	Qendra Komunitare	0	0	0	0	0	0	0
A.3.6.7	Mensa (Konviktet)	782	398	600	600	600	600	600
A.3.6.8	Kopshtet	0	0	0	0	0	0	0
A.3.6.9	Çerdhet	506	700	1.200	1.200	1.200	1.200	1.200
A.3.7	Tarifa për furnizimin me ujë dhe kanalizime	0	0	0	0	0	0	0
A.3.8	Tarifa për shërbimin e ujitjes dhe kullimit	0	0	0	0	0	0	0
A.3.9	Tarifa e përkohëshme	0	0	0	0	0	0	0
A.3.10	Tarifa të tjera	8,011	6,912	12,000	12,000	12,000	12,000	12,000
A.4	Të Ardhurat e Tjera	9,233	41,992	10,482	10,482	10,482	10,482	10,482
A.4.1	Qeraja nga asetet në pronësi të bashkisë	7.708	29.628	9.702	9.702	9.702	9.702	9.702
A.4.2	Kthimi nga investimet kapitale	0	0	0	0	0	0	0
A.4.3	Fitimi nga ndërmarrjet publike në varësi të Bashkisë	600	552	560	560	560	560	560
A.4.4	Kthimi nga partneriteti publik privat	0	0	0	0	0	0	0
A.4.5	Tërheqje e të ardhura krijuar nga shërbimet	0	0	0	0	0	0	0
A.4.6	Shitja e mallrave dhe shërbimeve	0	0	0	0	0	0	0
A.4.7	Kundravajtjet administrative (Gjobat)	543	107	100	100	100	100	100
A.4.8	Sekuestrime dhe Zhdëmtime	192	180	120	120	120	120	120
A.4.9	Kuotat e anëtarësisë së bashkive	0	0	0	0	0	0	0
A.4.10	Trasferta dhe ndihma nga njësitë e tjera vendore	0	0	0	0	0	0	0
A.4.11	Grante nga ndihma ndërkombëtare	190	11.525	0	0	0	0	0
A.4.12	Shitja e aseteve financiare	0	0	0	0	0	0	0
A.4.13	Shitja e aseteve fikse të prekshme / paprekshme	0	0	0	0	0	0	0
A.4.14	Të tjera	0	0	0	0	0	0	0

B	Transferta nga Buxheti Qendror	239,343	272,550	281,276	281,276	317,084	307,898	319,447
B.1	Transferta e Pakushtëzuar	129,814	138,073	146,455	146,455	176,278	167,092	178,641
B.2	Transferta e Kushtëzuar		0	0	0	0	0	0
B.2.1	Për funksionet e deleguara		0	0	0	0	0	0
B.2.2	Për projekte të veçanta (FZHR dhe të tjera)	0	0	0	0	0	0	0
B.3	Trasferta e Pakushtëzuar Sektoriale	109,528	134,477	134,821	134,821	140,806	140,806	140,806
C	Huamarrja	0	0	0	0	0	0	0
C.1	Huamarrja Afatshkurtër	0	0	0	0	0	0	0
C.2	Huamarrja Afatgjatë	0	0	0	0	0	0	0
D	Trashëgimi nga Viti i Shkuar	10,193	12,948	37,725	37,725	0	0	0
D.1	Trashëgimi Pa Destinacion	0	0	0	0	0	0	0
D.2	Trashëgimi Me Destinacion	10,193	12,948	37,725	37,725	0	0	0
	TOTALI I FONDEVE BUXHETORE	303,432	372,601	389,001	389,001	387,084	377,898	389,447


4.1.1.1 Të ardhurat e Veta të Bashkisë Skrapar

Taksat vendore përfshijnë taksa mbi pasurinë e paluajtshme, në të cilën përfshihen taksa mbi ndërtesat, taksa mbi tokën bujqësore dhe taksa mbi truallin, si dhe mbi transaksionet e kryera me to; b) taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja; c) taksa vendore mbi veprimtarinë e shërbimit hotelier; ç) taksa e tabelës; d) taksa vendore të përkohshme, të cilat vendosen sipas mënyrës së parashikuar në ligj; dh) taksa vendore mbi veprimtarinë ekonomike të biznesit të vogël; e) taksa vendore mbi të ardhurat vetjake, taksa mbi të ardhurat e krijuara nga dhuratat, trashëgimitë, testamentet ose lotaritë vendore; ë) taksa të tjera, të përcaktuara me ligj.

1-Taksa mbi pasurin e paluajtshme

BURIMET BUXHETORE		2021	2022	2023	2023	2024	2025	2026
		Fakti	Fakti	Buxh. Fillestar	Pritshmi	Plani	Plani	Plani
A.1.2	Taksa mbi pasurinë e paluajtshme	7,840	7,896	13,120	13,120	13,120	13,120	13,120
A.1.2.1	Taksa mbi ndërtesën	2,301	2,840	3,583	3,583	3,583	3,583	3,583
A.1.2.2	Taksa mbi tokën bujqësore	4,919	4,722	8,398	8,398	8,398	8,398	8,398
A.1.2.3	Taksa mbi truallin	620	327	1,049	1,049	1,049	1,049	1,049
A.1.2.4	Taksa mbi transaksionet e pasurisë	0	0	0	0	0	0	0

Në planin e taksave mbi pasurinë e paluajtshme peshën më të madhe e zë taksa mbi tokën bujqësore që është planifikuar në vlerën prej 8,398,000 lekë, më pas taksa mbi ndërtesën në vlerën prej 3,583,000 leke, dhe në fund taksa mbi truallin në vlerën prej 1,049,000 lekë. Gjithashtu vërejmë se niveli arkëtimit të taksës së tokës është rreth 56 % të vlerës së planifikuar. Ky tregues është i ulët për arsye se pjesa më e madhe e familjeve që kanë përfituar toke nga ligji 7501, nuk janë rezidentë në territorin e bashkisë Skrapar, kështu që vjelja 100%, e kësaj takse, është e pamundur. E njëjta gjë vlen dhe për taksën e truallit ku niveli i realizimit është rreth 45%, pasi kjo taksë vilet kryesisht nga familjet bujqësore që kanë të regjistruar truallin mbi të cilin kanë ndërtuar shtëpitë e tyre.



-Te dyja këto taksa përbejnë 50% të faktit të të ardhurave nga taksat, 42%, të planit të të ardhurave nga taksat 9%, të faktit të të ardhurave nga burimet e veta për vitin 2022, dhe 18.7%, të planit të të ardhurave nga burimet e veta për periudhën 2024-2026.

2- Te ardhurat nga taksa e ndare

BURIMET BUXHETORE		2021	2022	2023	2023	2024	2025	2026
		Fakti	Fakti	Buxh. Fillestar	Pritshmi	Plani	Plani	Plani
A.2	Të Ardhurat nga Taksat e Ndara	9,329	8,733	9,400	9,400	9,400	9,400	9,400
A.2.1	Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë / pasuritë e paluajtshme	0	5	0	0	0	0	0
A.2.2	Taksa vjetore për qarkullimin e mjeteve të përdorura	5,985	5,020	5,530	5,530	5,530	5,530	5,530
A.2.3	Taksa e rentës minerare	45	18	20	20	20	20	20
A.2.4	Taksa mbi të ardhurat personale	3,299	3,690	3,850	3,850	3,850	3,850	3,850
A.2.5	Taksa të tjera	0	0	0	0	0	0	0


Bashkia merr një pjesë të të ardhurave të mbledhura nga qeveria qendrore nga tatimi mbi të ardhurat personale, taksa e regjistrimit të automjeteve dhe renta minerare. Informacioni për këto të ardhura është paraqitur në tabelën e mësipërme.

Si vihet re dhe nga tabela, këto taksa kanë një nivel realizimi shumë afër nivelit të planifikuar. Taksa vjetore e qarkullimit të mjeteve të përdorura është realizuar në vlerën prej 5,985,000 lekë, për vitin 2021; 5,020,000 lekë për 2022, është planifikuar për 2023 -2026, në vlerën prej 5,530,000 lekë. Realizimi i kësaj takse ndër vite është stabil, pasi arkëtohen nga Drejtoria Rajonale e Shërbimit të Transportit Rrugor dhe pjesa që i takon Bashkisë i kalohet nëpërmjet llogarisë së të ardhurave të Thesarit. E njëjta gjë vlen dhe për tatimin mbi të ardhurat personale i cili përlllogaritet nga Drejtoria e Tatimeve dhe kalohet në llogarinë e të ardhurave të thesarit për Bashkinë Skrapar. Të dyja këto taksa përbejnë 50%, të faktit të të ardhurave nga taksat, 42%, të planit të të ardhurave nga taksat 10%, të faktit të të ardhurave nga burimet e veta për vitin 2022, dhe 13%, të planit të të ardhurave nga burimet e veta për periudhën 2024-2026.

3-Të ardhurat nga tarifat vendore

BURIMET BUXHETORE		2021	2022	2023	2023	2024	2025	2026
		Fakti	Fakti	Buxh. Fillestar	Pritshmi	Plani	Plani	Plani
A.3	Të Ardhurat nga Tarifat Vendore	25,978	27,213	36,087	36,087	36,087	36,087	36,087
A.3.1	Tarifa me menaxhimit te mbetjeve	9,100	12,487	13,177	13,177	13,177	13,177	13,177
A.3.3	Tarifa për ndriçimin publik	1,538	2,051	2,697	2,697	2,697	2,697	2,697
A.3.4	Tarifa për gjelbërimin	345	556	1,789	1,789	1,789	1,789	1,789
A.3.5	Tarifa për shërbimet administrative të bashkisë	5,696	4,109	4,625	4,625	4,625	4,625	4,625
A.3.6	Tarifa të institucioneve të arsimit, kulturës, sportit etj	1,288	1,097	1,800	1,800	1,800	1,800	1,800
A.3.10	Tarifa të tjera	8,011	6,912	12,000	12,000	12,000	12,000	12,000

TARIFAT VENDORE SIPAS KLASIFIKIMIT



Nga tabela por dhe nga paraqitja grafike tarifa e pastrimit zë peshën më të madhe në totalin e të ardhurave nga tarifat në vitin 2021, është realizuar në vlerën 9,100,000 lekë, në vitin 2022, në vlerën 12,487,000 lekë, dhe plani i vitit 2023, dhe parashikimi për periudhën 2024-2026, është në vlerën prej 13,177,000 lekë. Niveli realizimit në vitin 2022, ka qenë shumë afër nivelit të planifikuar dhe diferenca e vogël midis planit të vitit 2023, dhe parashikimit për periudhën e PBA-së, dhe faktit të vitit 2022, tregon se ka një planifikim real të të ardhurave nga tarifa e pastrimit.

Edhe në zërin tarifa të tjera, plani i vitit 2022, dhe parashikimi për periudhën e PBA-së, 2024-2026, është në vlerën 12,000,000 lekë. Realizimi në këtë zë, për vitin 2021, është në vlerën prej 8,011,000 lekë, ndërsa për vitin 2022, është në vlerën prej 6,912,000 lekë. Shohim një luhatje në realizimin e kësaj tarife, dhe kjo për arsye se në këtë zë, ka raste të arkëtimit të disa tarifave të pa parashikuara në planin e të ardhurave.

Tarifa e ndriçimit në vitin 2021, është realizuar në vlerën prej 1,538,000 lekë, në vitin 2022, në vlerën prej 2,051,000 lekë, plani i vitit 2023, dhe parashikimi për periudhën e PBA 2024-2026, është në vlerën prej 2,697,000 lekë. Diferenca e faktit të vitit 2022, me planin e 2023 dhe parashikimin për periudhën e PBA-së, është e arritshme për tu realizuar.

Tarifa e gjelbërimit në vitin 2021, është realizuar në vlerën prej 345,000 lekë, në vitin 2022, në vlerën prej 556,000 lekë, plani i vitit 2023, dhe parashikimi për periudhën e PBA 2024-2026, është në vlerën prej 1,789,000 lekë. Diferenca e faktit të vitit 2022, me planin e vitit 2023, dhe parashikimin për periudhën e PBA-së, është e madhe për shkak të nivelit të ulët të vjeljes së kësaj tarife. Gjithsesi, synohet rritja e nivelit të arkëtimit si gjatë vitit 2023, por dhe në vitet në vijim të periudhës PBA-së.

Tarifat për shërbimet administrative të bashkisë në vitin 2021, është realizuar në vlerën prej 5,596,000 lekë, në vitin 2022, në vlerën prej 4,109,000 lekë, plani i vitit 2023, dhe parashikimi për periudhën e PBA 2024-2026, është në vlerën prej 4,625,000 lekë. Diferenca e faktit të vitit 2022, me planin e vitit 2023, dhe parashikimin për periudhën e PBA-së, është e vogël dhe e arritshme për tu realizuar në vitet në vijim.

Tarifat arsim sport, kulturë; në vitin 2021, është realizuar në vlerën prej 1,288,000 lekë, në vitin 2022, në vlerën prej 1,097,000 lekë, plani i vitit 2023, dhe parashikimi për periudhën e PBA-së 2024-2026, është në vlerën prej 1,800,000 lekë. Diferenca e faktit të vitit 2022, me planin e vitit 2023, dhe parashikimin për periudhën e PBA-së, është e arritshme për tu realizuar në vitet në vijim.

Krahasuar me faktin e vitit 2022, të ardhurat nga tarifat vendore janë parashikuar në vlerën prej 8,874,000 lekë. Rritja më e madhe është në zërin e tjera tarifa, ku për vitin 2023, janë parashikuar pothuajse dyfishi i faktit të realizuar në vitin 2022.

4-Të ardhura të tjera

BURIMET BUXHETORE		2021	2022	2023	2023	2024	2025	2026
		Fakti	Fakti	Buxh. Fillestar	Pritshmi	Plani	Plani	Plani
A.4	Të Ardhurat e Tjera	9,233	41,992	10,482	10,482	10,482	10,482	10,482
A.4.1	Qeraja nga asetet në pronësi të bashkisë	7,708	29,628	9,702	9,702	9,702	9,702	9,702
A.4.2	Kthimi nga investimet kapitale	0	0	0	0	0	0	0
A.4.3	Fitimi nga ndërmarrjet publike në varësi të Bashkisë	600	552	560	560	560	560	560
A.4.4	Kthimi nga partneriteti publik privat	0	0	0	0	0	0	0
A.4.5	Tërheqje e të ardhura krijuar nga shërbimet	0	0	0	0	0	0	0
A.4.6	Shitja e mallrave dhe shërbimeve	0	0	0	0	0	0	0
A.4.7	Kundravajtjet administrative (Gjobat)	543	107	100	100	100	100	100
A.4.8	Sekuestrime dhe Zhdëmtime	192	180	120	120	120	120	120
A.4.9	Kuotat e anëtarësisë së bashkive	0	0	0	0	0	0	0
A.4.10	Trasferta dhe ndihma nga njësitë e tjera vendore	0	0	0	0	0	0	0
A.4.11	Grante nga ndihma ndërkombëtare	190	11,525	0	0	0	0	0
A.4.12	Shitja e asetëve financiare	0	0	0	0	0	0	0
A.4.13	Shitja e asetëve fikse të preکشme / paprekshme	0	0	0	0	0	0	0
A.4.14	Të tjera	0	0	0	0	0	0	0

Si vihet re nga tabela zëri të ardhura të tjera për vitin 2021, është realizuar në vlerën prej 9,233,000 lekë, të përbëra përkatësisht nga:

- a-Të ardhura nga asetet në pronësi të bashkisë në vlerën prej 7,708,000 lekë.
- b-Të ardhura nga shërbimet funerale të Nd.Sh.Publike në vlerën prej 600,000 lekë.
- c-Të ardhura nga gjoba (kundra vajtje administrative) në vlerën prej 543,000 lekë.
- d-Të ardhura nga sekuestrime dhe zhdëmtime në vlerën prej 192,000 lekë.
- e-Grante nga ndihma ndërkombëtare në vlerën prej 190,000 lekë.

Ndërsa fakti i vitit 2022, është në vlerën prej 41,992,000 lekë.

- a-Të ardhura nga asetet në pronësi të bashkisë, në vlerën prej 29,628,000 lekë.
- b-Të ardhura nga shërbimet funerale të Nd.Sh.Publike, në vlerën prej 552,000 lekë.
- c-Të ardhura nga gjoba (kundra vajtje administrative) në vlerën prej 107,000 lekë.
- d- Të ardhura nga sekuestrime dhe zhdëmtime në vlerën prej 180,000 lekë.
- e-Grante nga ndihma ndërkombëtare në vlerën prej 11,525,000 lekë.


Diferenca midis faktit të vitit 2022, dhe faktit të vitit 2021, është në vlerën prej 34,284,000 lekë.

Arsyeja është se për vitin 2022, kemi të ardhura nga grante ndërkombëtare, në vlerën prej 11,525,000 lekë, si dhe të ardhura nga asetet në pronësi të bashkisë, në vlerën prej 29,628,000 lekë.

Pritshmëritë për këtë zë të ardhurash në vitin 2023, si dhe për periudhën e PBA-së, janë në vlerën prej 10,482,000 lekë. Synohet të realizojmë më shumë të ardhura në këtë zë buxhetor, nisur nga fakti se Bashkisë Skrapar ka asete të konsiderueshme në pronësi nga të cilat mund të gjenerojmë të ardhura.

TE ARDHURTA NGA BURIMET E VETA TE BASHKISE

BURIMET E VETA BUXHETORE		2021	2022	2023	2023	2024	2025	2026
		Fakti	Fakti	Buxh. Fillestar	Pritshmi	Plani	Plani	Plani
A	TE ARDHURAT NGA BURIMET E VETA	53,896	87,032	70,000	70,000	70,000	70,000	70,000



Nga paraqitja grafike shohim se në të ardhurat nga Burimet e Veta ka diferencë midis faktit të vitit 2023, dhe faktit të vitit 2022. Efekt pozitiv ka pasur ndryshimi i paketës fiskale në vitin 2022, në të cilën u bë ndryshimi i nivelit të tarifave për biznesin e madh dhe kompanitë e shfrytëzimit të gurit dhe mermerit. Po ashtu efekt në nivelin e realizimit ka pasur dhe nga zëri të ardhura nga asetet në pronësi të bashkisë, sidomos të ardhura nga dhënia në përdorim e një sipërfaqe të konsiderueshme toke, një kompanie e cila do investojë në fushën e prodhimit të energjisë (prodhimin e energjisë alternative), po ashtu në vitin 2022, kemi realizuar të ardhura nga grante dhe ndihma ndërkombëtare të cilat nuk mund të kemi të realizueshme për çdo vit.

Diferenca midis planit të vitit 2023, parashikimit për periudhën e PBA-së, 2024-2026, ndaj realizimit faktik të vitit 2021, është 16,104,000 lekë. Kjo diferencë vjen nga rritja e tarifave për subjekte të biznesit të madh dhe të nxjerrjes së pllakave të gurit dhe mermerit, por dhe klasifikimit të bizneseve sipas natyrës dhe diferencimin e tarifave sipas këtij klasifikimi. Po ashtu rritja e nivelit të vjeljes së të ardhurave si rezultat i një angazhimi më të mirë duke filluar nga viti 2021, e në vazhdim.

Për sa me sipër nivelin e planifikuar të të ardhurave nga burimet e veta në vlerën prej 70,000,000 lekë, është një objektivi i arritshëm.


Nga ana tjetër politikat e qeverisë për rritjen e pagave dhe sidomos të rritjes së nivelit të pagës minimale ka një efekt të konsiderueshëm financiar shtesë në zërin e shpenzimeve për paga dhe sigurime shoqërore për punonjësit e bashkisë. Ky fakt do të ndikojë në prishjen e raporteve që ishin konsoliduar përsa i përket strukturës së buxhetit të Bashkisë në tre zërat kryesore të tij, Investime, Shpenzime personeli dhe Shpenzime operative. Duke marrë në konsideratë politikat

e qeverisë për rritjen e pagave, Grupi Menaxhimit Strategjik bëri korrigjimet e nevojshme të Tavaneve Përgatitore të Shpenzimeve, të miratuar me VKB-në, nr.14, datë 28.03.2023.

Duke qenë se të ardhurat nga burimet e veta përbejnë vetëm 18%, të totalit të burimeve buxhetore, kuptohet që me të ardhurat nga burimet e veta nuk mundet të mbulojmë dot kostot shtesë, si rezultat i rritjes së pagave, prandaj për këtë arsye, Ministria e Financave duhet të kompensojë këtë diferencë, duke rritur Tranferten e Pakushtëzuar të Përgjithshme.

B- TRANSFERTA NGA BUXHETI QENDROR

BURIMET BUXHETORE		2021	2022	2023	2023	2024	2025	2026
		Fakti	Fakti	Buxh. Fillestar	Pritshmi	Plani	Plani	Plani
B	Transferta nga Buxheti Qendror	239,343	272,550	281,276	281,276	317,084	307,898	319,447
B.1	Transferta e Pakushtëzuar	129,814	138,073	146,455	146,455	176,278	167,092	178,641
B.2	Transferta e Kushtëzuar		0	0	0	0	0	0
B.2.1	Për funksionet e deleguara		0	0	0	0	0	0
B.2.2	Për projekte të veçanta (FZHR dhe të tjera)	0	0	0	0	0	0	0
B.3	Trasferta e Pakushtëzuar Sektoriale	109,528	134,477	134,821	134,821	140,806	140,806	140,806




Si vrehet dhe nga paraqitja grafike kemi një rritje të konsiderueshme të nivelit të transfertave nga buxheti qendror, nga 281,276 leke në vitin 2023 në 317,084 leke në vitin 2024. Kjo rritje vjen si pasojë e rritjes së nivelit të pagave për punonjësit e Njesive të Vetqeverisjes V

4.1.1.3 Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme

Të ardhurat nga transferata e pakushtëzuar e përgjithshme për periudhën afatmesme që i kalojnë pushtetit vendor komunikohen nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë përmes Udhëzimit Vjetor dhe atij Plotësues të Përgatitjes së PBA-së.

BURIMET BUXHETORE	2021	2022	2023	2023	2024	2025	2026
	Fakti	Fakti	Buxh. Fillestar	Pritshmi	Plani	Plani	Plani
B.1 Transferta e Pakushtëzuar e Përgjithshme	129,814	138,073	146,455	146,455	176,278	167,092	178,641




